

VENDIM
Nr.1037, datë 14.10.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR KRUMË-GOLAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Krumë-Golaj.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 133 (njëqind e tridhjetë e tre) m², tokë/truall, dhe objekt, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 680 766 (dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 347 000 (treqind e dyzet e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 680 766 (dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.10.2009 dhe të përfundojë më 30.12.2009.

7. Pronari i përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrin e pasurisë në pronësi të pronarit që shpronësohet.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

RRETHI HAS
KOMUNA GOLAJ
FSHATI LETAJ

LISTA EMËRORE E PRONARIT QË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “KRUMË-GOLAJ”

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas.	Truall			Objekt	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Vlera lekë		
1.	Petrit	Bajram	Cuni	2431	1	133	1370	182210	2498556	2680766	Konfirmuar nga ZRPP
						133		182210	2498556	2680766	